



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3.5.2023

Nr: 427

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË AGJENCISË SË LAJMEVE BULLGARE, (BTA), AGJENCISË ANADOLU (AA), PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot në datën 3.5.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat e:

KËRKUES: Agjencia e Lajmeve Bullgare (BTA) me seli në Bullgari dhe me përfaqësues z. Kiril Valchey;

Agjencia “Anadolu” me adresë Rruga “Panorama”, Ndërtesa 3, Tiranë dhe me përfaqësues z. Ahmet Gjinishi;

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi i përfaqësuesve të Medias për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë 27.1.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

V Ë R E J:

Agjencia e Lajmeve Bullgare (BTA) i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 1(një) gazetar si dhe zonë e vëzhgimit . Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Agjencia e Lajmeve

Data: 3.5.2023 Nr: 427
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të Agjencisë së Lajmeve Bullgare, (BTA), Agjencisë Anadolu (AA), për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Bullgare (BTA) është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Agjencia “Anadolu” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 2 (dy) gazetarë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Shoqëria Agjencia “Anadolu” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 19, datë 27.1.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

V E N D O S :

1. Akreditimin e një (një) gazetari të Agjencisë së Lajmeve Bullgare (BTA), për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin e 2 (dy) gazetarëve të Agjencisë “Anadolu”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI